



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUZILACKI SAVET KOSOVA SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT ARKIVA - ARHIVA		
Pranuar 03 -03- 2023 Priljeno		
Numri rendor Redni broj	Ora e pranimit Ças prijema	Nentshkrimi i pranuesit Potpis primaoca
356		

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.3/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nenad Lazic, anëtar të kolegjit, në çështjen disiplinore, ndaj Ramiz Buzhala, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë (KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur në procedurën e ankesës kundër vendimit të KPK-së, nr.1579/2022, të datës 23 dhjetor 2022, në seancë të kolegjit të mbajtur më datë 10.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paraqitur nga Ramiz Buzhala, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, ndërsa vendimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës në Prishtinë, KPK/nr.1579/2022, i datës 23 dhjetor 2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Këshilli Prokurorial i Kosovës në Prishtinë (KPK), me vendimin KPK/nr.1579/2022, të datës 23 dhjetor 2022, në pikën I të dispozitivit ka vendosur, aprovohet raporti i panelit hetimor AD.nr.05/2022 i datës 24 nëntor 2022 në rastin disiplinor të kryeprokurorit Ramiz Buzhala, Prokuroria Themelore në Gjakovë. Në pikën II të dispozitivit është vërtetuar se kryeprokurori Ramiz Buzhala ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Ndërsa në pikën III të dispozitivit kryeprokurorit Ramiz Buzhala i



shqiptohet sanksioni disiplinor, transferim i përhershëm në Prokurorinë Themelore në Pejë, Prokuror në Departament të Përgjithshëm, sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij vendimi prokurori në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar vendimin për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit, shkeljeve procedurale të përcaktuara me ligj dhe gabimit faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës me propozim që: Gjykata e Supreme e Kosovës ankesën e subjektit hetimor ta aprovoj në tërësi dhe të anuloj vendimin disiplinor të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/nr.1579/2022, të datës 23 dhjetor 2022 dhe çështjen ta kthej në Këshillin Prokurorial në rishqyrtim, ose ankesën ta aprovoj në tërësi dhe vendimin e KPK-së ta ndryshoj duke e liruar atë nga përgjegjësia disiplinore, nëse e gjen përgjegjës ta ndryshoj masën disiplinore dhe ti shqiptojë ndonjë masë shumë më të butë në pajtim me shkeljen e gjetur.

Me përgjigje në ankesë, KPK ka propozuar që ankesa e paraqitur të refuzohet ndërsa vendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me vendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka gjetur se:

Ankesa e kryeprokurorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se KPK me datë 14 korrik 2022 nga Autoriteti Kompetent ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor, me pretendimin se Ramiz Buzhala – kryeprokurorë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se me datë 13 korrik 2022 ka shpërndarë pyetje nga testi me shkrim që duhej të mbahej në të njëjtën ditë nga aplikantët për bashkëpunëtorët profesional në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, Prizren dhe Pejë, ashtu që përmes WhatsApp-it, pyetjet e testit me shkrim i kishte dërguar në adresë të [REDACTED] dhe pastaj përmes komunikimit me telefon kishte kërkuar nga e njëjta që ti fshijë pyetjet, mesazhet e dërguara, duke theksuar se ishin dërguar gabimisht te e njëjta, me të cilat veprime i njëjti kishte për të kryer shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 2,



nënparagrafi 2.10 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më datë 14 korrik 2022 Këshilli Prokurorial i Kosovës ka marrë vendim me numër KPK/nr.801/2022, me të cilin z.Ramiz Buzhala, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Gjakovë është suspenduar menjëherë nga ushtrimi i detyrës zyrtare me pagesë 50% të pagës së tij, deri në një vendim të ri.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me vendimin KPK/Nr.803/2022 të datës 14 korrik 2022, ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.05/2022, ndaj z. Ramiz Buzhala, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Paneli Hetimor pas hetimit të rastit, në bazë të nenit 13 të Ligjit me nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 14 (7), (8) të Rregullores nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve me subjektin e hetimit ka arritur marrëveshje vullnetare për zgjidhjen e kësaj çështjeje disiplinore. Palët në negociim të marrëveshjes për pranimin vullnetar të fajësisë janë pajtuar që Këshillit Prokurorial të Kosovës t'i rekomandojnë sanksionin disiplinor transferim të përhershëm nga pozita e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë në pozitën e Prokurorit në Departamentin e Krimeve të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prizren, konform nenit 7 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Këshilli Prokurorial me datë 30 shtator 2022 ka mbajtur seancë dhe me shumicë votash ka refuzuar marrëveshjen vullnetare duke i kthyer rastin Panelit Hetimor për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike të shkeljes disiplinore. Në raportin e ri, AD.nr.05/2022, datë 23 nëntor 2022, Paneli Hetimor në bazë të provave dhe fakteve të paraqitura ka nxjerr përfundimin se në veprimet e Kryeprokurorit Ramiz Buzhala është vërtetuar shkelja disiplinore, andaj i është propozuar Këshillit Prokurorial që të aprovoj raportin.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, pas shqyrtimit të raportit të panelit, dëgjimit të kryesuesit të panelit dhe subjektit të hetimit si dhe pas vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka nxjerrë vendimin e atakuar KPK.nr.1579/2022, datë 23 dhjetor 2022, me të cilin është konstatuar se kryeprokurori Ramiz Buzhala është shpallur përgjegjës për shkelje



disiplinore dhe i është shqiptuar sanksioni disiplinor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të vendimit të atakuar.

KPK ka konstatuar se kryeprokurori Ramiz Buzhala është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduar nga autoriteti kompetent, për shkak se i njëjti ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse i njëjti përmes WhatsApp ka dërguar 11 pyetje nga testi me shkrim për bashkëpunëtorë profesional që sipas Panelit Hetimor në rastin konkret veprimet e subjektit të hetimit kanë dëmtuar reputacionin e vet kryeprokurorit dhe sistemit prokurorial në tërësi. Kryeprokurori Buzhala po ashtu gjatë seancës disiplinore në mbrojtjen e tij nuk e ka mohuar faktin që i ka dërguar pyetjet e testit për bashkëpunëtorë profesional, mirëpo ka theksuar se duke dashur t'ia dërgojë djalit porosinë gabimisht e ka përcjellë te gazetarja.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të vendimit të atakuar, KPK ju ka referuar nenit 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Gjykata Supreme e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, drejt dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Paraqitësi i ankesës pretendon në shkelje të nenit 13 të Rregullores nr.05/2019, apo ekzistimin e konflikt të interesit rreth përbërjes së këshillit, të cilën çështje thekson se e ka ngritur në seancën e datës 23.12.2022, mirëpo kjo gjykatë nuk ka mundur ta gjej një shkelje të tillë në bazë të shkresave të lëndës. Për ta trajtuar këtë pretendim, kjo gjykatë zyrtarisht ka kërkuar nga Këshilli Prokurorial procesverbalin e seancës të datës 23 dhjetor 2020, mirëpo nga përmbajtja e procesverbalit nuk rezulton që paraqitësi i ankesës të ketë ngritur pretendime të tilla, ashtu siç pretendon në ankesë.



Subjekti i hetimit pretendon se në këtë rast janë bërë shkelje ngase vendimi i referohet marrëveshjes vullnetare, mirëpo nuk është vërtetuar se ka bërë shpërndarjen e pyetjeve të testit tek ndonjë kandidat që ka hyrë në test për bashkëpunëtorë me datë 13.07.2022. Gjykata Supreme e vlerëson të pabazuar një pretendim të tillë, kjo pasi që deri te vërtetimi i shkeljes disiplinore nuk ka ardhur vetëm përmes asaj që subjekti i hetimit ka pranuar faktet e çështjes me marrëveshjen vullnetare me të cilën ka pranuar shkeljen dhe sanksionin, por kjo është vërtetuar edhe përmes provave të cilat janë marrë nga paneli hetimor dhe deklaratat e palëve në proces. Në këtë rast është vërtetuar se 11 nga pyetjet e testit me shkrim për provimin për bashkëpunëtorë profesional, që është dashtë të mbahet me datë 13.07.2022, përmes telefonit të kryeprokurorit të njëjtën ditë janë dërguar gabimisht te gazetarja, ku me këtë rast shtrohet çështja se si është e mundur që pyetjet e testit në telefonin e subjektit të hetimit të jenë të njëjta me pyetjet e testit për bashkëpunëtorë dhe të barten pikërisht ditën që është mbajtur provimi me shkrim. Në këtë rast është me rëndësi veprimi i kryeprokurorit në raport me procesin e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve dhe imazhi që është krijuar për këtë proces në opinionin publik. Pavarësisht nga ajo se veprimet e tilla janë bërë me dashje apo nga pakujdesia, pozita e subjektit të hetimit është e natyrës që nuk lejon veprime të tilla ngase dëmtojnë institucionin, reputacionin e prokurorit dhe besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e KPK-së, për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për arsye se me nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përcaktohet se: “*Shkelje e detyrave të prokurorit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se prokurori i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë: nën paragrafi 2.10 përcakton se: “përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit”*. Ndërsa me nenin 7 paragrafi 1 të këtij ligji përcaktohet se: “*Për shkelje disiplinore, këshillat përkatës mund ti shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore në vijim: 1.1. vërejtje jopublike me shkrim; 1.2. vërejtje publike me shkrim; 1.3. zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në 50% për një periudhë deri në një*



vit; 1.4. transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ultë; 1.5. propozim për shkarkim ”, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se; “Masat disiplinore shqiptohen vetëm në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë parasyshë: 2.1. numrin dhe seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga një gjyqtar apo prokuror; 2.2. pasojat e shkeljes disiplinore; 2.3. rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; 2.4. performanca dhe sjelljen e përgjithshme të gjyqtarit apo prokurorit dhe 2.5. sjelljen dhe nivelin e bashkëpunimit të gjyqtarit apo prokurorit gjatë procedurës disiplinore ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme erdhi në përfundim se KPK, drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe se është konstatuar përgjegjësia disiplinore e kryeprokurorit të pretenduar nga Autoriteti Kompetent, për çka edhe i'a ka shqiptuar sanksionin disiplinor. Po ashtu, Gjykata Supreme vlerëson se sanksioni disiplinor i shqiptuar nga KPK, është në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit për faktin se me rastin e vendosjes ka marrë parasysh seriozitetin e shkeljes disiplinore të kryer nga kryeprokurori, pasojat e shkeljes disiplinore, rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore, sjellja e përgjithshme e prokurorit si dhe sjellja dhe bashkëpunimi i prokurorit në procedurë disiplinore, rrethana këto që kanë ndikuar gjetjen e nivelit të proporcionalitetit, në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore, siç përcaktohet me nenin 7 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga arsyet e cekura Gjykata Supreme e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u mbështetur në nenin 15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË


A.A.nr.3/2023, me datë 10.02.2023

Kryetari i kolegjit

Zenel Leku



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTEJTON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Punëtori i autorizuar
Ovlašćenik